



31, tetor 2006

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ERO)

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në një seancë publike të mbajtur dje, më 30 tetor 2006, ka diskutuar dhe marrë vendim mbi 4 çështje të rëndësishme në sektorin e energjisë.

Bordi i ZRRE-së, sipas propozimit të Departamentit të Ngrohjes Qendrore dhe Gazit në ZRRE dhe duke u bazuar në prezantimin e bërë nga Astrit Saraqini, Kryesues i këtij Departamenti, ka votuar dhe ka aprovuar të hyrat e Lejuara për Kompaninë e Ngrohjes Qendrore "Termokos" për sezonin e ngrohjes 2006–2007, dhe të hyrat e Lejuara për Kompaninë e Ngrohjes Qendrore Gjakova për sezonin e ngrohjes 2006–2007. Bazuar në të hyrat e lejuara kompanitë e ngrohjes qendrore do të dorëzojnë propozimin e tyre për tarifa në ZRRE për aprovim.

Pas Prezantimit dhe propozimit të bërë nga Merita Kostari, Kryesuese e Departamentit Ligjor dhe për Licenca, Bordi i ZRRE-së me shumicë votash, gjithashtu ka vendosur të lëshoj licencë për këto kompani: Kompaninë aksionare CEZ a.s, me zyre të regjistruar në Pragë, ndërmarrjen Holding Slovenske Elektrane d.o.o, me zyre të regjistruara në Lubjanë të Sllovenisë, dhe kompaninë private OstElektra GmbH, me zyre të regjistruara në Oberhaching /Munich, Gjermani. ZRRE-ja deri më tani ka licencuar 7 kompani tregtuese, dhe me këtë veprim ka krijuar një bazë të mirë për konkurrencë në tregtimin e energjisë.

Një vendim tjetër i rëndësishëm është marrë në propozimin e KEK-ut në lidhje me miratimin e Procedurës së Përkohshme për Leximin e Matësve dhe Faturimin e Konsumatorëve me grup matës (me maksigraf). Prezantimi është bërë nga Azem Kastrati, Kryesues i Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRRE dhe procedurat e përfunduara u pranuan unanimisht nga Bordi i ZRRE-së.

Në fund Bordi mori vendim në lidhje me propozimin e KEK-ut për aplikimin e kamatës për borxhet e konsumatorëve ndaj KEK-ut, i cili ka propozuar një kamatë vjetore në shkallë prej 18,25 %. Pas prezantimit dhe arsyetimit të bërë nga Theranda Beqiri, Kryesuese e Departamentit për çmime dhe tarifa, bordi mori vendim për një normë të kamatës prej 14.65%; Kjo do të aplikohet për konsumatorët që vonojnë pagesën e faturave të tyre (35 ditë pas marrjes së faturës).